

# KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

## VENDIM

Nr. 55, Datë 15/08/2007

### PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË PËR ISH – REPARTIN 741.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës, në bazë të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” Neni 32, V.K.M. Nr. 500, datë 14.08.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, Ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, neni 8/2, dhe Ligjit Nr. 8744, datë 22/02/2001 “Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

### VENDOSI:

1. Të fillojnë procedurat për kalimin në pronësi të Bashkisë Korçë të Ish-Repertit 741, i cili mban nr rendor 496-510 në inventarin paraprak të pronave të paluajtshme shtetërore publike të Bashkisë Korçë,
2. T’i kërkohet Ministrisë së Brendshme dhe A.I.T.P.P. (Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike), kalimi i Ish-Repertit 741 në pronësi të Bashkisë Korçë me destinacion ndërtimin e banesave kolektive, objekteve sociale dhe tregëtare.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

  
KRYETARI  
RAIMONDA NASE